NJOFTIM PUBLIK PËR RREGULLOREN KUNDËR DISKRIMINIMIT

Është rregullore e New York City Department of Education (Departamentit të Arsimit të Qytetit të Nju Jorkut, DOE) që të ofrojë mundësi të barabarta p unësimi në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe pa marrë parasysh racën, ngjyrën, fenë, bindjen, etninë, origjinën kombëtare, statusin si i huaj, statusin e shtetësisë, moshën, statusin martesor, statusin e partneritetit, aftësinë e kufizuar, orientimin seksual, gjininë (përfshirë identitetin gjinor ose shprehjen gjinore reale ose të perceptuar, si dhe shtatzëninë ose kushtet që lidhen me shtatzëninë apo lindjen), gjatësinë, peshën, statusin ushtarak, statusin e papunësisë, historikun e mëparshëm të arrestimeve ose dënimeve, statusin si kujdestar, historikun e kreditit të konsumatorit, karakteristikat gjenetike predispozuese, historikun e pagave, vendimet për shëndetin seksual dhe riprodhues, ose statusin si viktimë e dhunës në familje, veprave penale seksuale ose përndjekjes së vazhdueshme, si dhe të mbajë një mjedis të lirë nga ngacmimet mbi bazën e cilësdo prej kategorive të mbrojtura të përmendura më sipër, përfshirë ngacmimin seksual dhe hakmarrjen.

Është rregullore e DOE që të ofrojë mundësi të barabarta arsimore në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe pa marrë parasysh racën, ngjyrën, fenë, moshën, bindjen, etninë, origjinën kombëtare, statusin si i huaj, statusin e shtetësisë, aftësinë e kufizuar, orientimin seksual, gjininë (përfshirë identitetin gjinor ose shprehjen gjinore reale ose të perceptuar, si dhe shtatzëninë ose kushtet që lidhen me shtatzëninë apo lindjen), ose peshën, dhe të mbajë një mjedis të lirë nga ngacmimet mbi bazën e cilësdo prej kategorive të mbrojtura të përmendura më sipër, përfshirë ngacmimin seksual dhe hakmarrjen.

Është rregullore e DOE që të sigurojë që programet, shërbimet dhe aktivitetet e DOE-së, përfshirë takimet publike të DOE-së, të jenë të qasshme për prindërit, kujdestarët, nxënësit dhe personat e tjerë që bashkëpunojnë me DOE-në, punojnë me punonjësit ose nxënësit e DOE-së, përdorin objektet e DOE-së ose ndërveprojnë në mënyra të tjera me DOE-në, pa marrë parasysh racën, ngjyrën, fenë, moshën, bindjen, etninë, origjinën kombëtare, statusin si i huaj, statusin e shtetësisë, aftësinë e kufizuar, orientimin seksual, gjininë, gjatësinë, peshën, statusin martesor, statusin e partneritetit ose statusin ushtarak, qofshin këto reale apo të perceptuara.

Kjo rregullore është në përputhje me Titullin VI dhe Titullin VII të Civil Rights Act of 1964 (Ligji për të Drejtat Civile i vitit 1964), Titullin IX të Education Amendments of 1972 (Ndryshimet në Ligjin për Arsimin të vitit 1972), Age Discrimination in Employment Act of 1967 (Ligji kundër Diskriminimit në Punësim për Shkak të Moshës i vitit 1967), Seksionin 503 dhe Seksionin 504 të Rehabilitation Act of 1973 (Ligji për Rehabilitimin i vitit 1973), Fair Labor Standards Amendments of 1974 (Ndryshimet në Standardet e Drejta të Punës të vitit 1974), Immigration Reform and Control Act of 1986 (Ligji për Reformën dhe Kontrollin e Imigracionit i vitit 1986), The Americans with Disabilities Act of 1990 (Ligji për Amerikanët me Aftësi të Kufizuara i vitit 1990), Civil Rights Act of 1991 (Ligji për të Drejtat Civile i vitit 1991), ligjet shtetërore dhe të qytetit të Nju Jorkut për të Drejtat e Njeriut, si dhe dispozitat kundër diskriminimit të përfshira në marrëveshjet kolektive të punës të Departamentit të Arsimit të Qytetit të Nju Jorkut.

Chancellor's Regulation A-830 (Rregullorja e Kancelarit A-830) përcakton procedurat që punonjësit, prindërit e nxënësve, nxënësit dhe personat e tjerë që bëjnë biznes me DOE-në, punojnë me punonjësit ose nxënësit e DOE-së, përdorin objektet e DOE-së ose ndërveprojnë në mënyra të tjera me DOE-në duhet të ndjekin për të paraqitur ankesa për diskriminim të paligjshëm, ngacmim nga punonjës të DOE-së ose nga individë që nuk janë të punësuar nga DOE-ja, por që punojnë me punonjësit ose nxënësit e DOE-së, si dhe për hakmarrje që lidhet me ankesa të tilla. Ankesat mund të paraqiten duke kontaktuar Office of Equal Opportunity & Diversity Management (Zyra për Mundësi të Barabarta dhe Menaxhimin e Diversitetit, OEO) ose duke i paraqitur ato pranë një prej agjencive të listuara më poshtë. Një kopje e Rregullores së Kancelarit A-830 mund të merret nga OEO ose në https://www.schools.nyc.gov/about-us/policies/chancellors-regulations.

Burimet e DOE-së:

Zyra Kryesore:

Office of Equal Opportunity & Diversity Management
(Zyra për Mundësi të Barabarta & Menaxhimin e Diversitetit)
New York City Department of Education (Departamenti i Arsimit i Qytetit të Nju Jorkut)
110 William Street, 15th Floor
New York, NY 10038
Tel: 718-935-3320
oeoinquiries@schools.nyc.gov

Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë me Title IX duhet t'i drejtohen:

Title IX Coordinator (Koordinatori i Title IX)
110 William Street, 15th Floor
New York, NY 10038
Tel: 718-935-4987
Title_IX_Inquiries@schools.nyc.gov

Pyetjet në lidhje me përshtatjet sipas Seksion 504 duhet t'i drejtohen:

Section 504 Coordinator
Office of School Health
(Koordinatori i Seksionit 504
Zyra e Shëndetit në Shkollë)
110 William Street, 15th Floor
New York, NY 10038
Tel: (212) 287-0354
504Questions@schools.nyc.gov

Burime të Jashtme:

- U.S. Equal Employment Opportunity Commission, New York District Office (Komisioni i SHBA-së për Mundësi të Barabarta në Punësim, Zyra e Distriktit të Nju Jorkut) – 33 Whitehall Street 5th Floor, New York, NY 10004 – 212-336-3620
- Office for Civil Rights, New York Office U.S. Department of Education (Zyra për të Drejtat Civile, Zyra e Nju Jorkut, Departamenti i Arsimit i SHBA-së) – 32 Old Slip, 26th Floor, New York, NY 10005-2500 – 646-428-3900
- New York State Division of Human Rights (Divizioni i të Drejtave të Njeriut i Shtetit të Nju Jorkut) – 1 Fordham Plaza – 4th floor, Bronx, NY 10458 – 718-741-8400
- New York City Commission on Human Rights (Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Qytetit të Nju Jorkut) – 22 Reade Street – 1st floor, New York, NY 10007 – 212-306-7450